

Për kë

Shërbimet tona të logopedisë, psikologjisë dhe psikomotorikës iu destinohen nxënësve nga klasa 1H deri 11H (parashkollor – shkolla fillore – CO cikli orientues).

Shërbimet tona

Psikologjia

Psikolog-ët/-et mund t'iu ndihmojnë fëmijëve që hasin vështirësi:

- për të mësuar (leximin, shkrimin, mësimin përmendësh, përqëndrimin...)
- në sjellje (ndruajtje ose frikë, shqetësim, ...)
- në kontrollin e emocioneve
- në marrëdhënie (agresiv, shkaktues i rrahjes ose përlëshjes, refuzon nxënësit tjerë, ...)
- në familje (marrëdhënie me prindër, me vëllezër e motra, ndarje të prindërve, pikëllim, ...)
- duke bërë vlerësim për të kuptuar më mirë origjinën e një problemi

Është me rëndësi për të ditur se psikolog-ët/-et:

- bëjnë propozime, por nuk marrin vendime
- mund të ndihmojnë në zhblokimin e situatës aty ku ka shumë vuajtje
- mund të ndihmojnë nxënësit për mësim në shkollë
- mund t'iu japin këshilla edhe prindërve dhe mësimdhënësve
- dhe janë në dispozicion të prindërve për shkëmbime dhe takime

Shërbimi psikomotorik

Terapeut-ët/-et për psikomotorikë mund të ndihmojnë nxënësit që hasin vështirësi:

- në lëvizje, në drejtëpeshim, në koordinimin e gjesteve, ...)
- të tonusit (gjeste të buta ose përkundrazi të forta, të prera (jo të rregullta), të pamenduara (të rrëmbyeshme)
- në anësi (është i pavendosur të shkruaj me dorën e majtë ose të djathtë, ngatërro anën e tij të majtë dhe djathtë)
- për orientim në hapësirë (nuk arrin të bëjë një vizatim ose të ndërtoj diçka, nuk mund të orientohet në një hartë)
- për orientim në kohë (ngatërro para-pas, nuk mund të bëjë dallimin sa i përket momenteve të ditës, javës, ritmet, ...)
- në mungesë besimi
- në aftësitë grafomotorike (shkrim në mënyrë të lexueshme)
- në kontrollin e emocioneve

Logopedia

Logoped-ët/-et mund të ndihmojnë nxënësit që hasin vështirësi:

- në të shprehur (në frëngjisht dhe në gjuhën e tyre amtare)
- në shqiptimin e disa tingujve ose disa fjalëve
- në ndërtimin e fjalive në mënyrë të saktë
- në mësimin e fjalëve të reja
- për të kuptuar atë që iu është thënë me gojë
- në belbëzim
- në mësimin e leximit dhe për të kuptuar një tekst
- për të bërë një tekst me shkrim (drejtshkrim)
- për të gjykuar (logjikuar) në matematikë
- në çrregullim të gëlltitjes (fëmijët lajmërohen nga ana e ortodontistit)

Logoped-ët/-et, psikolog-ët/-et dhe terapeut-ët/-et për psikomotorikë janë të detyruar/-a t'i nënshtrohen sekretit profesional dhe nuk mund të transmetojnë informata të nevojshme të mësimdhënësit pa pëlqimin e prindërve.

Si duhet bërë kërkesa

- Për të bërë kërkesën për ndihmë në logopedi, psikologji ose psikomotorikë, është e nevojshme të plotësoni një formular lajmërimi të cilën do ta gjeni në web-faqen www.slppi.ch ose në web-faqen <https://www.fr.ch/dics/formation-et-ecoles/4-15-ans/services-de-logopedie-psychologie-et-psychomotricite>.
- Ju mund t'i drejtoheni edhe mësimdhënësit të fëmiut tuaj ose terapeutëve (logoped-ëve/-eve, psikologë-ve/-eve ose terapeut-ëve/-eve për psikomotorikë) të shkollës, për të mësuar si plotësohet formulari për lajmërim.
- Pastaj, ju duhet të dërgoni këtë formular lajmërimi në adresën:

SLPPI
Rte de Moncor 14
1752 Villars-sur-Glâne

- Nëse kërkesa e ndihmës për logopedi, psikologji dhe psikomotorikë pranohet nga Drejtoria e SIPLP, atëherë shërbimi do të jetë falas dhe për këtë do të merrni konfirmim me shkrim. Për shërbime të psikologjisë ose logopedisë, duhet të kontaktoni terapeutët, ndërsa në kërkesën për psikomotorikë janë terapeutët që do t'ju kontaktojnë.

Rrjedha

- Sipas rregullave të përgjithshme, terapeutët në fillim do të bëjnë një vlerësim për të analizuar dhe shikuar gjendjen.
Varësisht nga rezultati i këtij vlerësimi, propozohet edhe vazhdimi gjegjësisht terapia.

Përkthimi

- Nëse nuk flisni ose nuk e kuptoni mjaftueshëm frëngjishten, terapeutët (logoped-ët/-et, psikolog-ët/-et ose terapeut-ët/-et për psikomotorikë) mund të sigurojnë një përkthyes që flet gjuhën tuaj.

Terapeutët e shkollës së fëmiut tuaj (shkollës së Noréaz / Ponthaux / Prez-vers-Noréaz)

- Nëse keni nevojë për informacione, ju mund të drejtoheni drejtpërdrejt te:

Zonja Lola Faure, Zonja Ulpia Gheorghita, logopede, në numrin 026 475 35 07 / 026 470 04 32.


Zonja Sophie Pabst, Zonja Georges Albrecht, psikologe, në numrin 026 475 35 07 / 026 470 04 32.

Zonia Raphaël Caloz, specialiste për psikomotorikë, në numrin 026 407 38 63/66 (terapeutet për psikomotorikë të Shërbimit kanë lokalet e tyre në Villars-sur-Glâne).

Ose te

Sekretariati i SLPPI në numrin 026 407 38 62

Avec le soutien de :



ETAT DE FRIBOURG
STAAT FREIBURG

Bureau de l'intégration des migrant-e-s
et de la prévention du racisme IMR
Fachstelle für die Integration der MigrantInnen
und für Rassismusrävention IMR